



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 52 të Ligjit, për Vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të neneve 34, 40, 41, 47 të Statutit të komunës së Shtërpçës nr. 01/898 të datës 14.07.2010, Kuvendi Komunal Shtërpçë në seancën e mbajtur më 29.01.2018 miratoi këtë:

VENDIM
PER FORMIMIN E KOMITETIT PER POLITIKE DHE FINANCA

Neni 1

Me këtë vendim Komiteti për Politikë dhe financa formohet prej anëtareve nga përbërja e Kuvendit të Komunës dhe ate siq vujon:

1. Predrag Grbic- Kryesues i komitetit
2. Ana Milosavljevic -SL
3. Miroslav Djordjevic -SL
4. Dragomir Stanisavljevic-SL
5. Blerta Hazizi PDK

Neni 2

Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa i kryeson Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i cili në marrëveshje me Kryetarin e Komunës duhet të vendosë për çështjet të cilat duhet të shqyrtohen në këtë Komitet. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e ka të drejtën e një vote shtesë, nëse ka numër të barabartë të votave për dhe kundër propozimit të caktuar.

Neni 3

Komiteti për politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm, dhe çdo ndryshim të buxhetit për vitin fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 4

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

Neni 5

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa të emëruar me nenin 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Shtërpçës.

- Anetarev të zgjedhur.**
- Drejtorise për buxhet dhe financa**
- MAPL-se dhe**
- Arkivit**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Predrag Grbic

